



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 117, Datë 22.07.2019

MBI

MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË “MARRËVESHJEN PËR SIGURIMIN E SHËRBIMIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET “OSHEE” SH.A. DHE FURNIZUESVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE”, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 24, DATË 15.02.2017, I NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR. 58, DATË 15.04.2019

Në mbështetje të nenit 16, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 26 të “Rregullave të Organizimit, Funkcionimit dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s, nr.96, datë 17.06.2016, nenin 19, pika 2 të “Marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sha, dhe furnizuesve të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 24, datë 15.02.2017, i ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 15.04.2019, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.07.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Çështjeve Ligjore “Mbi miratimin e ndryshimit të marrëveshjes për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet “OSHEE”sha dhe furnizuesve të energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 24, datë 15.02.2017, i ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 15.04.2019”,

Konstatoi se:

- ERE me vendimin e bordit nr. 24, datë 15.02.2017 ka miratuar “*Marrëveshjen e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sha dhe furnizuesve të energjisë elektrike*”, ndryshuar me vendimin e bordit nr. 58, datë 15.04.2019.
- ERE në vendimin e bordit nr. 91, datë 31.05.2019 “Mbi një ndryshim në “*Marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet “OSHEE” sha dhe furnizuesve të energjisë elektrike*”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 24, datë 15.02.2017, i ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 15.04.2019”, ka vendosur: *Fillimin e procedurës për ndryshimin e nenit 20, pika 1 të “Marrëveshjes për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet “OSHEE” sha dhe furnizuesve të energjisë elektrike*”, miratuar me vendimin e Nr. 24, datë 15.02.2017, i ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 15.04.2019.
- ERE me shkresën e saj nr. 402 Prot, datë 13.06.2019 ka njoftuar vendimin nr. 91, datë 31.05.2019, subjekteve si: “OSHEE” sha, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë,

Autoritetit të Konkurrencës, Shoqatës “FIAA” si dhe “Shoqatës Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike” (AAES) duke kërkuar nga ata opinione dhe sugjerime lidhur me ndryshimin e kësaj marrëveshje, brenda 15 ditëve nga marrja dijani.

- ERE në shkresën me nr. 32/30 Prot, datë 06.06.2019, ka bërë njoftimin në median e shkruar, lidhur me vendimin nr. 91, datë 31.05.2019.
- Autoriteti i Konkurrencës, në shkresën e tij me Nr.380/2 Prot, datë 02.07.2019 protokolluar në ERE me Nr. 402/1 prot, datë 03.07.2019 shprehet se: *Autoriteti i Konkurrencës mbasi shqyrtoi marrëveshjen e miratur me vendimin e ERE-s nr. 91, datë 31.05.2019 konstaton se marrëveshja nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”.*
- Duke qenë se marrëveshjet me furnizuesit, lidhen konform “Marrëveshjes TIP”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 24, datë 15.02.2017, ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 15.04.2019, dhe po ashtu asnjë nga palët e vëna në dijeni nuk kanë shprehur kundërshti mbi ndryshimet e propozuara, me procedurën e nisur me Vendimin nr. 91, datë 31.05.2019 të bordit të ERE-s, gjykohet i arsyeshëm amendimi i “Marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a dhe furnizuesve të energjisë elektrike”, duke ndryshuar nenin 20, pika 1 (ekzekutimi nga palët) të saj.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE :

Vendosi:

1. Miratimin e ndryshimit të nenit 20, pika 1 të “Marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sha, dhe furnizuesve të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Nr. 24, datë 15.02.2017, i ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 15.04.2019 si më poshtë:
 - Neni 20.1 ndryshon, “Kjo Marrëveshje hartohet në 5 kopje origjinale, në gjuhën Shqipe, secila me vlerë të njëjtë ligjore, 2 për secilën Palë dhe 1 dërgohet në ERE për dijeni”
2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore, të njoftojë subjektet e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
PETRIT AHMETI